

VENDIM
Nr. 985, datë 1.2.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “*Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve*”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 11 datë 22.10.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**MARION STOJKU**”, protokolluar me nr. 6466 prot., datë 16.11.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 1/“a”/iii të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “*Për lejet e mjedisit*”. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimit nr. 11 datë 22.10.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 500.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “MARION STOJKU” sh.p.k., ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.